



MANUAL

DHËNIA E BURSIVE DHE PËRCAKTIMI I KRITEREVE, SIPAS
PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR SHTETASIT E HUAJ ME
ORIGJINË SHQIPTARE TË CILËT PËRFITOJNË BURSA
STUDIMI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Agjencia Kombëtare e Diasporës duke patur parasysh objektin e veprimtarisë institucionale, duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit me Diasporën shqiptare me qëllim dhënien e bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, si dhe në përmbushje të angazhimeve në kuadër të Vendimit Nr. 686, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021”, hap thirrjen për aplikim për studentët që janë pjesë e komunitetit shqiptar dhe kanë interes të studiojnë në Republikën e Shqipërisë.

Për vitin akademik 2020-2021 do të akordohen 9 (nëntë) bursa për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë për vendet si më poshtë vijon:

a. 3 (tre) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina;

b. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të komunitetit Arbëresh në Itali;

c. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare në Kroaci;

d. 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Bullgaria;

Kriteret bazë për përfitimin e bursës për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare janë:

1. Të ketë mbaruar arsimin e mesëm me një mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë) ose të barasvlefshme me të;

2. Të mos jetë i diplomuar në ciklin e plotë të studimeve universitare;

3. Të jetë student nga komunitetet shqiptare të diasporës dhe që jeton në një nga vendet e mëposhtme:

- Pjesë e komunitetit shqiptar në Ukrainë;
- Pjesë e komunitetit Arbëresh në Itali;
- Pjesë e komunitetit shqiptar në Kroaci;
- Pjesë e komunitetit shqiptar në Bullgari.

Kriteret shtesë për përfitimin e bursës Studentët, shtetas të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursë duhet të plotësojnë edhe këto kriteret:

1. Të jenë studentë në një nga fushat prioritare të studimit, të përcaktuara më poshtë;
2. Të kenë vërtetim nga universiteti se janë studentë aktivë që nuk kanë përfunduar ciklin e plotë të studimeve;
3. Të kenë një plan pune dhe aktivitete të kërkimore apo akademike gjatë periudhës studimore në Shqipëri;

Fushat prioritare të studimit për studentët, shtetas të huaj me origjinë shqiptare, që përfitojnë bursa nga shteti shqiptar janë:

a) Shkenca shoqërore

- a. Psikologji
- b. Ekonomi dhe biznes
- c. Edukim
- d. Sociologji
- e. Ligj/drejtësi
- f. Shkenca politike
- g. Gjeografi
- h. Media dhe komunikim

b) Shkenca humane dhe arte

- a. Histori
- b. Arkeologji
- c. Gjuhë
- d. Letërsi
- e. Arte
- f. Shkenca të tjera humane

Dokumentat e nevojshëm për aplikim

CV
Kopje e pasaportës
Vërtetim studenti
Listë notash
Letër motivimi

Kujdes: Dokumentet që shoqërojnë aplikimin dhe vërtetojnë plotësimin e kriterëve duhet të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

Mënyra e përzgjedhjes:

Misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë të akredituara në vendet e përmendura në pikën 3, të Vendimit Nr. 686, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021”, bëjnë propozimet për kandidatët për përfitimin e bursës për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për vitin akademik 2020-2021. Ato janë përgjegjëse për dërgimin e dokumentacionit të kërkuar për kandidatët përfitues të bursës.

Vlerësimi përfundimtar i dokumenteve të kandidatëve të cilët do të përfitojnë bursë studimi do të bëhet nga Komisioni i Bursave për Diasporën, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, një nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, një nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe një nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Kujdes: Në vitin e parë të studimeve për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare do të kryhen mësimet e gjuhës shqipe, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë për vitin akademik 2020-2021.

MASA E BURSËS PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE

STUDENTËT ME ORIGJINË SHQIPTARE	
Tarifa e studimit	40000 lekë/vit = 30 Euro/muaj
Akomodimi	300 Euro/muaj
Shpenzimet ushqimore	270 Euro/muaj
Totali mujor i bursës	600 Euro /muaj

